



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 139 Datë, 21.08.2020

“MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “YLLIAD”
SH.P.K., NR. 9, SERIA T15, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË
ERE-S, NR. 97, DATË 28.07.2015”.**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2 gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”; nenit 5, pika 1, gërma “e”; nenit 8, nenit 9, nenit 10, pikat 1 dhe 3, si dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE- s nr.109, datë 29.06.2016, i ndryshuar, nenit 19, pika 1, gërma “a” të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.08.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr.96/5prot datë 17.08.2020 e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “YLLIAD” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Me shkresën nr. ref. YTL 04-2020, datë 29.07.2020, protokolluar në ERE me nr. 1013/1 prot, datë 29.07.2020, shoqëria “YLLIAD” sh.p.k. ka depozituar ne ERE aplikimin për rinovimin e licencës nr. 9, seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s, nr. 97, datë 28.07.2015.
- Bordi i ERE-s, me vendimin Nr. 97, datë 28.07.2015, ka vendosur:
“Të rinovojë licencën e shoqërisë “YLLIAD” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të komisionerëvetë ERE-s nr. 108, datë 22.12.2010, për një afat 5-vjeçar.
- Në zbatim edhe të pikës 1, gërma a, të vendimit të bordit nr. 133/2020, ku është vendosur të shtyhet deri më 01.09.2020, afati i dorëzimit të aplikimit për rinovim licence të të gjitha subjekteve, afati për aplikim për rinovim licence i të cilave përfundon, apo ka përfunduar deri

në 30 Qershor 2020, shoqëria legjitimohet në kërkesën për rinovimin e licencës duke e vlerësuar atë të kryer brënda parashikimeve ligjore të miratuara nga ERE

- Rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit dhe pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Aplikimi i shoqërisë “YLLIAD” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” “c”), **është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.**
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”), **është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.**
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), **është plotësuar pjesërisht.**

Mungon **gërma “c”** (Dokumenta që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.). Shoqëria ka depozituar shkresën e OTP BANK, ku përcakohet volumi në euro i shoqërisë në këtë bankë. Po ashtu shoqëria ka deklaruar kapitalin financiar të parashikuar për ushtrimin e aktivitetit të tregimit të energjisë, i cili rezulton më i lartë se gjendja bankare e shoqërisë. Sa më sipër, edhe pse rezulton që bilancet e saj janë mbyllur me fitim, do t’i kërkohej shoqërisë të informojë ERE-n në lidhje me mënyrën se si parashikon të garantojë këtë diferencë në shumën e parashikuar.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), **është plotësuar pjesërisht.**

Mungon **gërma “b”** (Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vertetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj.). Duke qenë se shoqëria ka deklaruar kapitalin financiar i parashikuar për ushtrimin e aktivitetit të tregimit të energjisë elektrike është më i lartë se shuma që rezulton nga gjendja bankare e shoqërisë, edhe pse referuar pasqyrave financiare të shoqërisë, rezulton që bilancet e saj janë mbyllur me fitim, do t’i kërkohej shoqërisë të informojë ERE-n në lidhje me mënyrën se si parashikon të garantojë këtë diferencë në shumën e parashikuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 9, Seria T15, të shoqërisë “YLLIAD” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 97, datë 28.07.2015, për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI